

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6174
E mërkurë, 25 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Mustafa: Më mirë të gjejmë zgjidhje për presidentin sesa të shkojmë në zgjedhje

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | FAQE 4-5

KOSOVËS I DUHET NJË QEVERI E UNITETIT



Ish-ministrja për Dialog, kryetarja e Alternativës Demokratike të Kosovës (ADK), Edita Tahiri, ka thënë se Kosova është në një gjendje shumë të rëndë, duke marrë parasysh gjendjen me pandeminë dhe përballjen me Gjykatën Speciale. Për t'u bërë ballë këtyre dy proceseve, Tahiri thotë se

është i domosdoshëm krijimi i një qeverie të unitetit, ku do të përjashtoheshin fillimisht zgjedhjet e reja. Ajo thotë se kjo gjendje në të cilën ndodhet Kosova kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit për të siguruar një mbrojtje shtetërore sa më

të mirë për ish-krerët e UÇK-së dhe ish-ushtarët e UÇK-së që po përballen me Specialen në Hagë. Në këtë intervistë ish-zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. Vazhdimin e këtij dialogu ajo e lidh me krijimin e një qeverie të unitetit

AKTUALE



FILLON ZYRTARISHT TRANZICIONI I PUSHTETIT PRESIDENCIAL NË SHBA F. 2

GJYKATA REFUZON LIRIMIN ME KUSHT TË SALIH MUSTAFËS F. 6

GJENERAL RAMA VIZITOI SHTABIN SUPREM TË FORCAVE ALEATE TË EVROPËS, PARAQET OBJEKTIVAT E FSK-së F. 7

EKONOMI



HOTI PARALAJMËRON PAKO TË RE PREJ 182 MILIONË EUROVE PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 9

MPMS-ja DHE UNDP-ja MBËSHITESIN QYTETARËT DHE BIZNESET ME PAJISJE TË NEVOJSHME F. 9

KULTURË

DIPLOMACIA DHE KULTURA FUQIZOJNË PARTNERITETIN STRATEGJIK F. 5



ZEMAJ: SHIFRAT ME COVID JANË ALARMANTE, QYTETARËT T'I RESPEKTOJNË MASAT E QEVERISË

FAQE 3

Kosovës të martën i janë shtuar edhe 609 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 590 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve

janë regjistruar edhe 13 viktima. Duke komentuar të dhënat e fundit nga IKShPK-ja, ministri i Shëndetësisë Armend Zemaj ka thënë se situata epidemiologjike nuk është e mirë.

"Numrat janë alarmant. Për ta ndryshuar gjendjen, është e domosdoshme të ndryshojmë sjelljet tona, ndaj situatës, ndaj virusit vdekjeprurës", ka thënë Zemaj

BAROMETRI I BKS-SË: FSK-ja, INSTITUCIONI MË I BESUESHËM NGA QYTETARËT, QEVERIA MË E KORRUPTUARA

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Fillon zyrtarisht tranzicioni i pushtetit presidencial në ShBA

WASHINGTON, 24 NËNTOR- Presidenti amerikan, Donald Trump, ka pranuar që të fillojë një tranzicion zyrtar i pushtetit dhe që presidenti i zgjedhur, Joe Biden, të marrë detyrën. Presidenti Trump ka thënë se agjencia federale që mbikëqyr procesin e transferimit të pushtetit presidencial duhet të "bëjë atë që duhet të bëhet". Megjithatë, ai u zotua se do të vazhdojë të kundërshtojë humbjen e tij në zgjedhje. Më parë, Emily Murphy, administratorja e Administratës së Shërbimeve të Përgjithshme (GSA), njoftoi Bidenin se tranzicioni i tij përpara inaugurimit të 20 janarit mund të fillonte zyrtarisht.

Trump tha se ky proces është "në interesin më të mirë të vendit". "Unë jam duke rekomanduar që Emily dhe ekipi i saj të bëjnë atë që duhet bërë në lidhje me protokollet fillestare, dhe i kam thënë ekipit tim të bëjë të njëjtën gjë", ka shkruar Trump në "Twitter". Pas njoftimit të GSA-së, Pentagoni ka njoftuar se do të siguronte "mbështetje për ekipin e Bidenit në një mënyrë profesionale, të rregullt dhe efikase që i përshtatet pritjeve të publikut për Departamentin dhe angazhimit tonë për sigurinë kombëtare".

Administratorja Murphy tha se ajo po vinte 6.3 milionë dollarë fonde në dispozicion të presidentit të zgjedhur. Vendimi për transferimin e pushtetit do të thotë që ekipi i Bidenit më në fund mund të



fitojë qasje në agjencitë federale, të komunikojë me zyrtarë dhe të përdorë paratë e financuara nga taksapaguesit për të ndihmuar një tranzicion të qetë. Vendimi gjithashtu lejon që Biden dhe zëvendëspresidentja e zgjedhur, Kamala Harris, të marrin informacione të rregullta të sigurisë kombëtare, të cilat i pranon edhe Trumpi. Zhvillimet ndodhën pasi shteti i Miçiganit certifikoi fitoren e Bidenit, që shënoi një goditje e madhe për Trumpin.

Çfarë tha ekipi i Bidenit?

Ekipi i Bidenit mirëpriti fillimin e procesit të tranzicionit, ndërsa presidenti i zgjedhur

demokrat përgatitet të betohet më 20 janar. "Vendimi i sotëm është një hap i nevojshëm për të filluar trajtimin e sfidave me të cilat përballet kombi ynë, duke përfshirë vendosjen e pandemisë nën kontroll dhe ekonominë tonë përsëri në rrugën e duhur", ka deklaruar ekipi i Bidenit.

Vendimi për fillimin zyrtar të tranzicionit presidencial tregon se përpjekjet e Trumpit për të përmbysur rezultatin e zgjedhjeve të 3 nëntorit mbase po i afrohen fundit.

Zgjedhjet në Shtetet e Bashkuara janë mbajtur më 3 nëntor. Ato u fituan nga kandidati demokrat, Joe Biden, mirëpo presidenti aktual, Donald Trump (republikan), ka

refuzuar të pranojë rezultatin në disa shtete duke pretenduar - pa prova - se zgjedhjet ishin të manipuluar. Mirëpo, sfidat ligjore të ekipit të Trumpit nuk kanë pasur sukses në shumicën e rasteve.

Presioni i republikanëve

Së fundi në mesin e republikanëve janë shtuar zërat se presidenti Trump do të duhet të pranojë një tranzicion të pushtetit.

Të hënën më herët, senatori nga Tenesi, Lamar Alexander që është në përfundim të mandatit dhe ka bërë vazhdimisht thirrje për fillimin e tranzicionit, lëshoi një deklaratë të re duke thënë që zoti Trump duhej "të vinte

vendin në para së gjithash" dhe të ndihmonte administratën e zotit Biden të ketë sukses.

Senatori Republikan Rob Portman nga Ohajo i bëri thirrje të hënën Administratës së Shërbimeve të Përgjithshme që të vinte në dispozicion paratë dhe personelin e nevojshëm për tranzicionin.

Ndërkohë më shumë se 100 ish-zyrtarë republikanë thanë në një deklaratë se "refuzimi i Trumpit për të pranuar dhe lejuar një tranzicion të rregullt përbën një kërcënim serioz" për procesin demokratik të ShBA-së. Zyrtarët që nënshkruan letrën kanë shërbyer për katër presidentë republikanë, përfshirë Trumpin.



Cakaj takon Kamberin: Shpreh shqetësimin për proceset gjyqësore ndaj shqiptarëve të Luginës

TIRANË, 24 NËNTOR (ER)- Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme në Shqipëri, Gent Cakaj, ka zhvilluar të martën një takim me një prej përfaqësuesve politik të Luginës së Preshevës, Shaip Kamberi. Në

takim u diskutua domosdoshmëria e bashkëbiseduesit shprehën shqetësimin e thellë për një numër procesesh gjyqësore ndaj shqiptarëve, vetëm e vetëm për shkak të përdorimit të hapur të simboleve kombëtare.

takimit të zhvilluar, bashkëbiseduesit shprehën shqetësimin e thellë për një numër procesesh gjyqësore ndaj shqiptarëve, vetëm e vetëm për shkak të përdorimit të hapur të simboleve kombëtare.

Vaksinimi me Sputnik V do të kushtojë "më pak se 20 dollarë"

MOSKË, 24 NËNTOR- Mbështetësit financiarë dhe zhvilluesit e vaksinës ruse për koronavirus, Sputnik V, kanë thënë se dy dozat e nevojshme për vaksinim të një personi do të kushtojnë "më pak se 20 dollarë" në

tregjet ndërkombëtare derisa në Rusi do të jenë falas. Çmimi në tregun ndërkombëtar për Sputnik V është më i lirë sesa ai i vaksinave të rivalëve perëndimorë sikurse vakcina e prodhuar nga Pfizer, e cila

kushton më shumë se 18 dollarë për një vaksinë. Megjithatë, vakcina ruse është shumë më e shtrenjtë sesa ajo e prodhuar nga AstraZeneca, e cila në Evropë do të shitet për 3 dollarë.



Edhe 13 të vdekur dhe 609 raste të reja me Covid në Kosovë

Zemaj: Shifrat me Covid janë alarmante, qytetarët t'i respektojnë masat e qeverisë

Kosovës të martën i janë shtuar edhe 609 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 590 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar edhe 13 viktima. Duke komentuar të dhënat e fundit nga IKShPK-ja, ministri i Shëndetësisë Armend Zemaj ka thënë se situata epidemiologjike nuk është e mirë. “Numrat janë alarmant. Për ta ndryshuar gjendjen, është e domosdoshme të ndryshojmë sjelljet tona, ndaj situatës, ndaj virusit vdekjeprurës”, ka thënë Zemaj



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1 590 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 609 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar edhe 13 raste të vdekjes nga ky virus.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Suharekë tri raste (83,76, 68 vjeç), Prizren dy raste

(62, 57 vjeç), Deçan një rast (70 vjeç), Kamenicë një rast (63 vjeç), Junik një rast (56 vjeç), Mitrovicë një rast (83 vjeç), Obiliq një rast (75 vjeç), Pejë një rast (66 vjeç), Prishtinë një rast (69 vjeç) dhe Vushtrri një rast (67 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 35 549 raste nga 134 318 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 939 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 350 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 21 746 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 864.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 276 raste, Mitrovicë 53 raste, Gjiilan 35 raste, Podujevë 30 raste, Vushtrri 27 raste, Fushë-Kosovë 25 raste, Pejë 23 raste,

Skenderaj 19 raste, Ferizaj 17 raste, Drenas 13 raste, Obiliq 12 raste, Prizren 11 raste, Lipjan 10 raste, Klinë 9 raste, Viti 8 raste, Deçan 7 raste, Istog 7 raste, Suharekë 7 raste, Gjakovë 5 raste, Kamenicë 4 raste, Rahovec 3 raste, Shtime 3 raste, Junik 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Graçanicë, Kaçanik dhe Mamushë.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë,

Armend Zemaj, ka kërkuar të martën nga qytetarët që t'i zbatojnë masat e institucioneve kundër pandemisë Covid-19.

Ai ka thënë se shifrat me të infektuar me Covid janë alarmante. “Numrat janë alarmant. Për ta ndryshuar gjendjen, është e domosdoshme të ndryshojmë sjelljet tona, ndaj situatës, ndaj virusit vdekjeprurës. Të gjithë, MSh, IKShPK, shtabet

emergjente, task forcat nëpër shkolla, Policia e Kosovës, inspektoratet dhe kryetarët e komunave, janë në një front kundër virusit. Kemi ngritur të gjitha kapacitetet e mundshme. U bëjmë thirrje qytetarëve që të zbatojnë masat e Qeverisë, të na ndihmojnë neve dhe të gjithëve”, ka thënë Zemaj në një konferencë për medie me kryetarin e Gjiilanit, Lutfi Haziri.

Mustafa: Më mirë të gjejmë zgjidhje për presidentin sesa të shkojmë në zgjedhje



PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa ka thënë të martën para medieve se në fillim të dhjetorit apo në ditët në vijim pritet të organizojë një takim me subjektet tjera politike për të diskutuar çështjen e presidentit. “Sipas opinionit tonë është më mirë që çështja të zgjidhet tani sesa të shkojmë në zgjedhje dhe ta përsërisim edhe një herë situatën e njëjtë”, ka deklaruar Mustafa. Ai nuk ka pranuar të komentojë pyetjet nëse kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj do të jetë kandidat për president.

Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga pozita e presidentit të Kosovës në fillim të muajit

nëntor, pas aktakuzës që i është konfirmuar në Gjykatën Speciale, me seli në Hagë.

Aktualisht pozitën e presidentit e ushtron kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, nenit 90, në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij, ai mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Sipas Kushtetutës, posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj.



FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

KOSOVËS I DUHET NJË QEVERI E UNITETIT

Ish-ministrja për Dialog, kryetarja e Alternativës Demokratike të Kosovës (ADK), Edita Tahiri, ka thënë se Kosova është në një gjendje shumë të rëndë, duke marrë parasysh gjendjen me pandeminë dhe përballjen me Gjykatën Speciale. Për t'u bërë ballë këtyre dy proceseve, Tahiri thotë se është i domosdoshëm krijimi i një qeverie të unitetit, ku do të përjashtoheshin fillimisht zgjedhjet e reja. Ajo thotë se kjo gjendje në të cilën ndodhet Kosova kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit për të siguruar një mbrojtje shtetërore sa më të mirë për ish-krerët e UÇK-së dhe ish-ushtarët e UÇK-së që po përballen me Specialen në Hagë. Në këtë intervistë ish-zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. Vazhdimin e këtij dialogu ajo e lidh me krijimin e një qeverie të unitetit

një qeveri e unitetit dhe pastaj në një konsultë serioze ndërmjet të gjitha palëve, edhe me aleatët tanë, ShBA-në dhe Evropën, të vendoset në lidhje me ardhmërinë e këtij dialogu", është shprehur ajo.

Tahiri ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave. "Koha është që të liberalizohen vizat këtë vit dhe të mos shtyhet më tej ky proces, se me të vërtetë BE-ja ka rënë në provim para Kosovës sa i takon liberalizimit të vizave, por edhe të përshpejtohet procesi i hapjes së negociatave për anëtarësim të Kosovës", ka deklaruar Tahiri.

"Epoka e re": Znj. Tahiri, pas aktakuzave nga Gjykata Speciale për ish-krerët e UÇK-së, ju në disa paraqitje mediale keni bërë thirrje për qeveri të unitetit. Pse?

Edita Tahiri: Kosova është në një gjendje shumë të rëndë në përgjithësi, në njërën anë për shkak të pandemisë dhe inicimi i proceseve nga Gjykata Speciale e ka rënduar këtë gjendje edhe më shumë. Kjo gjendje kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit tonë. E para për të siguruar një mbrojtje

shtetërore sa më të mirë për ata që janë në gjykatë, në mënyrë që argumentimi të bëhet me një mbështetje sa më të madhe institucionale. Në këtë drejtim duhet të ketë një unitet politik dhe kombëtar. Në këtë kuadër kam bërë thirrje për një qeveri uniteti, që më të vërtetë do ta rriste kapacitetin institucional dhe nevojën për të folur me një gjuhë në këtë kohë të rëndë.

"Epoka e re": Kjo qeveri, çfarë përbërje do të duhej të kishte?

Edita Tahiri: Çështja e unitetit varet nga partitë sa e kanë prioritet interesin nacional të vendit tonë. Sikurse ta kishin të gjitha partitë prioritet interesin nacional, mendoj se të gjitha partitë që janë në parlament do të duhej të bashkoheshin në një qeveri uniteti. Nga përvoja e kaluar në këto dekada, edhe të periudhës së okupimit dhe të pasluftës, në momente strategjike për vendin ka ndodhur një lloj uniteti dhe kemi qenë shumë më të fortë për realizimin e synimeve. Nuk mund të paragjykoj se të gjitha mund të bashkohen, por një bazë e gjerë e partive

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ish-ministrja për Dialog, kryetarja e Alternativës Demokratike të Kosovës (ADK), Edita Tahiri, ka thënë se vendit urgjentisht i duhet një qeveri e unitetit, në të cilën do të përfaqësoheshin partitë politike parlamentare. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka theksuar se në momente strategjike për vendin ka ndodhur një lloj uniteti, ku Kosova ishte e fortë për realizimin e synimeve të veta. Ajo ka thënë se kjo qeveri

nuk ka vota të mjaftueshme për të kaluar një ligj i cili është jetik për qytetarët.

Tahiri ka thënë se qeveria e unitetit është më se e domosdoshme kur kemi parasysh se Kosova në këtë kohë është duke u përballur edhe me Gjykatën Speciale. "Kosova është në një gjendje shumë të rëndë në përgjithësi, në njërën anë për shkak të pandemisë dhe inicimi i proceseve nga Gjykata Speciale e ka rënduar këtë gjendje edhe më shumë. Kjo gjendje kërkon një mobilizim më të madh të institucioneve të shtetit tonë. E para për të siguruar një mbrojtje

shtetërore sa më të mirë për ata që janë në gjykatë, në mënyrë që argumentimi të bëhet me një mbështetje sa më të madhe institucionale", ka thënë Tahiri. Ajo ka theksuar se nëse nuk do të ketë mundësi për një unitet i cili ndërlihet edhe me çështjen e zgjedhjes së një presidenti konsensual, atëherë alternativa mund të mbesin zgjedhjet e reja. Në këtë intervistë ish-zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. Vazhdimin e këtij dialogu ajo e lidh me krijimin e një qeverie të unitetit. "Mendoj se fillimisht duhet të formohet

parlamentare duhet të reflektohet në një qeveri të unitetit, e cila është e domosdoshme.

“Epoka e re”: Aktualisht po mendoni se nuk ka një përpjekje për një unitet të tillë nga partitë?

Edita Tahiri: Jemi të gjithë dëshmitarë se është duke munguar uniteti. Një tregues është se edhe Projektligji për rimëkëmbje ekonomike ende nuk është miratuar, pra gjërat e mëdha nuk po kanë përkrahjen e votave të mjaftueshme për miratim. Përveç pandemisë, kemi edhe gjëra të tjera më të rëndësishme siç është ana ekonomike, sepse qytetarët janë lodhur nga kjo pandemi, në mungesë të të hyrave. Pastaj na gjeti edhe kjo situata me Gjykatën Speciale. Kështu që Kosova ka një agjendë të rëndë dhe kjo agjendë kërkon aftësi më të mëdha me bashkimin e partive në një qeveri.

“Epoka e re”: Këtë situatë aktuale, sipas jush, nuk mund ta përballojë koalicioni aktual qeverisës, duke pasur parasysh pandeminë dhe Gjykatën Speciale?

Edita Tahiri: Ky koalicion është në minimum të votave në parlament, pra me një minimum të legjitimitetit. Vetë fakti që parlamenti nuk po mbërrin t’i kryejë obligimet për shkak të votave të mjaftueshme, urgjentisht duhet të ndërmerren masa për të ndryshuar kjo gjendje. Në radhë të parë, të krijohet një qeveri e unitetit e cila me të vërtetë do të mund të çojë përpara Kosovën në planin e brendshëm, por edhe në planin ndërkombëtar. Mos të harrojmë se kemi edhe dialogun e Brukselit, pra kemi një agjendë të rrallë si shtet.

“Epoka e re”: Qeveri të unitetit duke përjashtuar zgjedhjet e reja?

Edita Tahiri: Në qoftë se nuk do të ketë mundësi për një unitet që ndërlihdet edhe me çështjen e

zgjedhjes së presidentit, që po mendoj se duhet të jetë konsensual, atëherë alternativa e vetme mund të mbesin zgjedhjet. Kanë një kohë përpara që duhet ta testojnë dhe në një moment të caktuar, kur shihet që nuk ka rezultat, atëherë ndoshta do të duhet të mendojnë edhe për zgjedhje.

“Epoka e re”: Ju përmendet edhe dialogun me Serbinë. Në këtë periudhë a do të duhej të ndërpritej për një kohë dialogu me Serbinë, kur kohën e fundit kemi parë një fushatë të egër të Serbisë ndaj Kosovës?

Edita Tahiri: Sjellja destruktive e Serbisë ka eskaluar edhe më shumë. E kam thënë këto ditë se derisa e gjithë bota mendon se si të lehtësohet gjendja e popullatës nga pandemia, Serbia e ka mendjen te lufta. E ka shtuar retorikën e luftës, madje bën edhe anketa në këto drejtime, që tregon se problemi kryesor i Ballkanit është Serbia, pra faktor destabilizues i sponsorizuar edhe nga politikat destruktive ruse. Kjo për Ballkanin është shqetësuese. Mendoj se partnerët euroatlantikë si ShBA dhe partnerët evropianë duhet të mobilizohen që Ballkani të mos kthehet edhe një herë në një fushëbetejë të agjendave gjeopolitike, përkundrazi duhet të ecin proceset e integritimit euroatlantike përpara. Kur jemi të proceset euroatlantike, mendoj se Bashkimi Evropian tani duhet të mendojë shumë më shumë për Kosovën. Koha është që të liberalizohen vizat këtë vit dhe të mos shtyhet më tej ky proces, se me të vërtetë BE-ja ka rënë në provim para Kosovës sa i takon liberalizimit të vizave, por edhe të përshejtohet procesi i hapjes së negociatave për anëtarësim për Kosovën. Pra t’i jepet statusi i kandidatit, sepse kjo është koha kur BE-ja mund të shtrijë një dorë më të fuqishme drejt Kosovës për ta mbështetur në proceset eurointegruese dhe euroatlantike.

Diplomacia dhe Kultura fuqizojnë partneritetin strategjik

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, dhe ministrja e Kulturës, Rinisë e Sporteve, Vlora Dumoshi, nënshkruan të martën marrëveshjen e shkallës së shërbimit midis dy ministrive përkatëse, e cila do të shërbejë për forcimin e diplomacisë kulturore të Republikës së Kosovës përmes fuqizimit të misioneve strategjike nëpër botë.

Ministrja e Punëve të Jashtme

dhe Diasporës, Haradinaj-Stublla, ka thënë se kjo marrëveshje është vazhdimësi e përpjekjeve të vazhdueshme për fuqizimin dhe reformimin e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, përmes së cilës do të zgjerohet gama e përfaqësimit të Kosovës nga ai diplomatik e ushtarak, tani edhe në atë kulturor.

Ndërkaq ministrja e Kulturës, Rinisë e Sportit, Vlora Dumoshi, ka thënë se me anë të kësaj marrëveshje mundë-

sohet emërimi i Atasheve Kulturorë të cilët do të promovojnë kulturën e Republikës së Kosovës në vendet ku ata akreditohen. “Atashe Kulturorë do të emërohen figurat emine të kulturës dhe sportit që kanë për qëllim përfaqësimin e vendit tonë në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës duke u bazuar në synimin e përbashkët për fuqizimin e diplomacisë kulturore dhe sportive”, është shprehur ajo.



“Epoka e re”: Pra dialogu me Serbinë duhet të vazhdojë?

Edita Tahiri: Mendoj se fillimisht duhet të formohet një qeveri e unitetit dhe pastaj në një konsultë serioze ndërmjet të gjitha palëve, edhe me aleatët tanë, ShBA-në dhe Evropën, të vendoset në lidhje me

ardhmërinë e këtij dialogu. Kosova duhet të jetë e zonja që t’ua bëjë të qartë partnerëve dhe miqve tanë ndërkombëtarë, se nëse Serbia nuk e ka ndërmend ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe e shfrytëzon këtë dialog për të treguar se gjoja është

konstruktive për ta përparuar agjendën e vet evropiane, atëherë ky dialog po kthehet në një proces të dëmshëm për Kosovën. Këto çështje i takojnë Qeverisë së Kosovës me partnerët ndërkombëtarë para se të merren vendime çfarëdo qofshin në raport me dialogun.

Nominimi i Antony Blinkenit për Sekretar të Shtetit të ShBA-së, lajm i mirë për shqiptarët

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Ish-ambasador i Kosovës në Australi dhe në Austri, Sabri Kijçari, ka thënë se nominimi i Antony Blinkenit për Sekretar të Shtetit të ShBA-së, është një sinjal i qartë se presidenti i zgjedhur Joe Biden do të ndjek një kurs krejt tjetër nga Administrata e presidentit Donald Trump. Sipas Kijçarit, Blinken do ta rikthejë politikën e bashkëpunimit me partnerët tradicionalë të ShBA-së dhe me këtë edhe do ta rikthejë rolin udhëheqës të ShBA-së në nivel global përmes vlerave euroatlantike. “Blinken

përshkruhet si njeri shumë i matur, i përbajtur, i orientuar drejt qëllimit dhe me mjaft përvojë në politikën e jashtme. Emërimi i Sekretarit të Shtetit Antony Blinken është lajm i mirë edhe për Kosovën dhe gjithë shqiptarët. Ai e njeh shumë mirë vendin tonë, ka qenë në mbështetje të drejtpërdrejtë të etablimentit të Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ka punuar ngushtë me presidentin Biden në të kaluarën”, ka shkruar Kijçari në llogarinë e vet në “Facebook”.



Gjykata refuzon lirimin me kusht të Salih Mustafës

PRISHTINË, 24 NËNTOR- Gjykatësi i procedurës paraprake në Dhomat e Specializuara në Hagë, Nicolas Guillou, ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes për lirimin me kusht të ish-epropolit të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa.

Në vendimin i cili është publikuar në faqen e Dhomave të Specializuara ndër arsyet e refuzimit përmendet "pozicioni i Mustafës brenda aparatit të sigurisë dhe inteligjencës së Kosovës, që i siguron atij qasje në informacione dhe burime që do lehtësojnë çdo përpjekje për të ikur; pengojnë procedurat përmes ndërhyrjes në viktima dhe dëshmitarë, ose të kryejë krime të mëtejshme".

Mustafa, në kohën e fundit, ka qenë zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes.

Mustafa u arrestua më 24 shtator në shtëpinë e tij që gjendet në periferi të Prishtinës, pasi i ishte konfirmuar aktakuza për dyshimet për kryerjen e krimeve të luftës, përfshirë këtu veprat penale si: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.

Arrestimi i Mustafës ishte i pari që nga themelimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, që njihen edhe si Gjykata Speciale në vitin 2015. Ai në paraqitjen e parë para gjykatësit të procedurës paraprake u deklarua i pafajshëm për akuzat për krime lufte të ngritura nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Në kërkesën për lirimin me kusht nga paraburgimi mbrojtja e Mustafës kishte paraqitur si arsye faktin se Mustafa "banon në Kosovë dhe dëshiron të rifillojë punën e tij aktuale", pastaj që ai është "paraqitur vullnetarisht për intervistim nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe se i njëjti do të dorëzojë vullnetarisht pasaportën e tij dhe do të paraqitet pranë Dhomave të Specializuara sipas kërkesës". Ndërsa prokuroria në kundërshtimin e saj ka thënë se "pas dorëzimit të materialit mbështetës të aktakuzës, tek Mustafa është rritur nxitja për të ikur sepse tash është i vetëdijshëm për mundësitë konkrete të dënimit, dhe se rreziku nga ikja është më e madhe marrë parasysh numrin



e kufizuar të shteteve me cilat Kosova ka marrëveshje për ekstradim".

Në njoftim e Dhomave të Specializuara thuhet se gjyqtari i procedurës paraprake do të rishikojë vendimin mbi paraburgimin e Mustafës pas dy muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin.

Gjykata e Kosovës e përbërë nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Specializuar e Prokurorisë në Hagë, është formuar me insistimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe financohet kryesisht nga Bashkimi Evropian. Gjykata është themeluar me vendimin e Kuvendit të Kosovës pas raportit

të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, në të cilin senatori zviceran Dick Marty flet për krimet e pretenduara "të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndaj pakicave etnike dhe rivalëve politikë", që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000.

Në UKZ kanë nisur takimet punuese për procesin e akreditimit institucional

GJILAN, 24 NËNTOR (ER)- Rektori i Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të procesit të akreditimit 2020/21, ka kërkuar mobilizimin e gjithë stafit të universitetit duke u nisur nga prorektorët, dekanët, prodekanët, stafit akademik dhe administratës, etj.

Përveç akreditimit institucional, në proces janë edhe 12 programe studimore për akreditim/riakreditim.

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan në proces të riakreditimit institucional, ka për riakreditim gjashtë programe: Fillor dhe Parashkollor (BA), Shkencat Kompjuterike (BA),



Finance dhe Kontabilitet i Aplikuar (BA), E-qeverisje (MA), Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (MA) si dhe për akreditim po ashtu ka në proces

gjashtë programe të reja: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA), Mësimdhënie e Kurrikula (MA), Kontrolla e Sistemeve dhe

Inteligjenca Artificiale (MSC), Menaxhim dhe Ndërmarrësi (MSC), Juridiko-Penal (MSc), Administrimi dhe e Drejta e Unionit Evropian (BSc).

Për këtë rektori Kosumi ka marrë vendim duke krijuar edhe agjendën për grupet punuese për secilin standard veç e veç (11 standarde ne total), të cilat grupe do të shkruajnë raportin e vetëvlerësimit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Grupet punuese do të punojnë çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, përgjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2020. Në kuadër të këtij procesi deri tani të gjitha dokumentet e kërkuara janë dorëzuar me kohe duke përfshirë edhe tabelën me bartës të të gjitha programeve studimore si dhe përfundimin e deklaratimit të Stafit Akademik në platformën E-Akreditimi.

Komuniteti i Transportit i ofron përkrahje Kosovës për sigurinë në trafikun rrugor

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu ka pritur të martën në takim Matej Zakonjsk, sekretar i përhershëm i Komunitetit të Transportit, e cila është organizatë ndërkombëtare në fushën e mobilitetit dhe transportit, e përbërë nga 33 pjesëmarrës - e gjithë BE-ja dhe gjashtë partnerët rajonalë të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë takim u diskutua për sigurinë e trafikut rrugor, e cila është një sfidë mjaft e madhe, me të cilën po ballafaqohen pothuajse të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, ashtu sikur edhe vendi ynë. Ministri Veliu ka theksuar se MPB-ja me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, bashkë me Policinë e Kosovës, vazhdimisht ka trajtuar dhe proceduar problemet në

infrastrukturë rrugore dhe ligjore dhe ka vazhduar bashkëpunimin me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Me këtë rast, Komuniteti i Transportit, ofroi mbështetje të plotë në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë në trafik dhe përmasimin e infrastrukturës rrugore.



Barometri i BKS-së: FSK-ja, institucioni më i besueshëm nga qytetarët, qeveria më e korruptuara

Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar edicionin e dhjetë të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS). Sipas këtij barometri, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të jetë institucioni më i besuar nga qytetarët, ndërkaq Qeveria e Kosovës konsiderohet institucioni më i korruptuar. Ky raport po ashtu thekson se institucionet e drejtësisë, përkatësisht gjykatat dhe prokuroria, vazhdojnë të perceptohen si të korruptuara

shtesë për arsyet pse ekzistojnë perceptime të tilla të qytetarëve në lidhje me çështjet e paraqitura në raport.

Gjetjet kyçe të edicionit të dhjetë të BKS-së janë si më poshtë: Të anketuarit e Barometrit Kosovar të Sigurisë vazhdojnë të kenë besim më të lartë në institucionet e sigurisë krahasuar me institucionet qendrore dhe të drejtësisë; Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të jetë institucioni më i besuar, me 81 për qind të të anketuarve që kanë besim ose besim të plotë në të; Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Dogana e Kosovës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës janë institucionet e sigurisë më pak të besuara; Në përgjithësi, institucionet e sigurisë perceptohen si më pak të korruptuara nga qytetarët, krahasuar me institucionet e drejtësisë dhe qendrore;

Institucionet e drejtësisë, përkatësisht gjykatat dhe prokuroria, vazhdojnë të perceptohen si të korruptuara. Mbi 40 për qind e të anketuarve besojnë se këto institucione janë të korruptuara ose shumë të korruptuara; Qeveria e Kosovës konsiderohet institucioni më i korruptuar, me 72 për qind të të anketuarve që deklarojnë se qeveria është e korruptuar ose shumë e korruptuar; Në përgjithësi, qytetarët kanë kontakt të drejtpërdrejt të ulët me institucionet në Kosovë; Komunitat janë institucionet me të cilat qytetarët kanë pasur më së shumti kontakt të drejtpërdrejtë në 12 muajt e fundit; dhe në raport theksohet se Qeveria është institucioni me të cilin qytetarët kanë pasur më së paku kontakt të drejtpërdrejtë në 12 muajt e fundit.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 NËNTOR- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar edicionin e dhjetë të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS). Barometri Kosovar i Sigurisë është një mjet i QKSS-së përmes të cilit maten perceptimet publike në Kosovë në lidhje me besimin e qytetarëve në institucione dhe çështje të ndryshme që lidhen me sigurinë. Në edicionin e tij të dhjetë, BKS-ja ka marrë një

shtrirje rajonale dhe është zhvilluar paralelisht në Kosovë dhe Serbi duke shënuar edicionin e parë të Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP).

Edicioni i BKS-së, raporti për Kosovën, përbëhet nga tre kapituj. Kapitulli i parë paraqet perceptimet e qytetarëve lidhur me besueshmërinë në institucionet e sigurisë, drejtësisë, si dhe në institucione e nivelit qendror dhe lokal. Në anën tjetër, kapitulli i dytë interpreton perceptimet e qytetarëve lidhur me

korruptionin në këto institucione. Së fundmi, në kapitullin e tretë reflektojnë të gjeturat e raportit për kontaktin e drejtpërdrejtë të qytetarëve me këto institucione në 12 muajt e fundit.

Teksa në kapitujt e lartpërmendur ky raport ofron një pasqyrë të përgjithshme të perceptimeve të qytetarëve, ai gjithashtu paraqet zbërthimin e të dhënave sipas gjinisë, rajonit, zonës (urbane/rurale), moshës (18-35/36+) dhe përkatësisë etnike të të anketuarve. Për më tepër, raporti ofron analiza



Gjeneral Rama vizitoi Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Evropës, paraqet objektivat e FSK-së

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneraljtënant Rrahman Rama ka qëndruar në vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Evropës (SHAPE) në Mons të Belgjikës ku u takua me komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë (SACEUR), gjeneralin Tod Wolters.

Fillimisht, gjeneral Rama ka falënderuar gjeneralin Wolters për angazhimin e trupave të NATO-s në kuadër të misionit të KFOR-it në funksion të sigurisë së përgjithshme në Kosovë si dhe mbështetjes së vazhdueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë. Gjithashtu, gjeneral Rama ka

shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për kontributin dhe angazhimin e Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në të gjitha aspektet.

Ai e ka njoftuar gjeneralin Wolters për të arriturat e gjithëmbarshme të FSK-së, procesin e tranzicionit, si dhe shkallën e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse të FSK-së. Ndër të tjera, gjeneral Rama, ka ritheksuar se të gjitha aftësitë dhe kapacitetet operacionale të FSK-së zhvillohen sipas standardeve të NATO-s në mënyrë që të jenë të ndërveprueshme me forcat e vendeve anëtare të NATO-s.

Ndërlidhur me këtë fakt, gjeneral Rama i ka shprehur gjeneralit

Wolters, gatishmërinë për ofrimin e kapaciteteve të FSK-së për pjesëmarrje në operacionet paqeruajtëse të Aleancës për të dhënë kontributin e saj në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë së përgjithshme.

Nga ana e tij, gjenerali Wolters ka përgëzuar gjeneralin Rama si dhe ka shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për të arriturat e deritashme të FSK-së si dhe kontributin e saj në sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm në vend dhe rajon. Ndër të tjera ai ka ritheksuar përkushtimin e NATO-s për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon. Të dy gjeneralët diskutuan për vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm të NATO-s përmes



kapaciteteve të KFOR-it dhe mekanizmave tjerë të NATO-s me FSK-në përmes shkëmbimit

të përvojave në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe profesionalizimit të FSK-së.

Oda e Hotelerisë dhe Turizmit paralajmëron padi ndaj qeverisë Kurti dhe Hoti



EPOKA E RE Albuelena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit ka paralajmëruar protesta në rast se as në seancën e ardhshme nuk kalon Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike. Po ashtu ka paralajmëruar se nuk do të respektojnë masat në fuqi. Pas më shumë se një orë e gjysmë takim, Oda e Hotelerisë

dhe Turizmit, ka marrë disa vendime në rast se nuk kalon Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Kryetari i kësaj ode, Hysen Sogojeva, ka thënë se së bashku me odat tjera, kanë ndikuar që të mos ketë mbyllje totale të vendit, duke shpëtuar edhe miliona euro. "E para u vendos që të kalohet sa më parë, bile në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës, Ligji për Rimëkëmbjen

Ekonomike të kalohet sa më parë. Përndryshe pas kësaj, nëse kjo nuk kalohet do të pasojnë protestat, ndoshta fillohet iniciativa e padëgjueshmërisë të këtyre masave aktuale. Pastaj të paguhet të gjithë punëtorët, sepse ende nuk janë paguar punëtorët të cilët e kanë pasur obligim. Interesi bankar të stopohet sa më parë, kjo mos të na i trazojë bizneset hoteliere

në Prishtinë", ka deklaruar ai. Sogojeva pas këtij takimi tha se po kërkohet edhe që të paguhet qiraja, pasi sipas tij njerëzit janë në hall. "Ne si Odë morëm vendim që të ngremë padi ndaj qeverisë së kaluar edhe kësaj aktuale, sepse deri në ligjin e pandemisë të gjitha vendimet kanë qenë antikushtuese, andaj ne do të ngremë padi kolektive, sepse dëmet të cilat janë bërë në atë kohë t'i

kthehen bizneseve", ka shtuar ai.

Sogojeva ka shtuar se do të dakordohen edhe me odat tjera, që në rast se edhe në seancën e ardhshme nuk kalon Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike, do të fillojnë daljen në protesta. Ndër tjera, kanë kërkuar sa më parë të shfuqizohen masat të cilat janë në fuqi, meqë siç tha ai këto nuk po ndihmojnë në mospërhapjen e Covid-19.

MPMS-ja dhe UNDP-ja mbështesin qytetarët dhe bizneset me pajisje të nevojshme



PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)-Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, të martën bashkë me përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, kanë takuar disa nga punëkërkuësit, të cilëve edhe u janë ndarë pajisjet e nevojshme për të filluar punën në bizneset e tyre, si përfutues të Programit të

Vetëpunësimit për të riatdhesuarit që është shpallur këtë vit.

Lidhur me këtë, ministri Reçica, ka thënë se, është shumë i lumtur që në këtë kohë të vështirë të përballjes me pandeminë Covid-19 dhe vështirësitë që ka sjellë në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve kjo, ne arritëm t'i

mbështesim me qindra qytetarë për t'u bërë pjesë e tregut të punës me anë të bizneseve të tyre. "Ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në bashkëpunim me partnerin tonë, Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, këtë vit nëpërmjet Fazës së parë të Programit të

Vetëpunësimit kemi përkrahur 136 punëkërkuësit në hapjen e bizneseve të tyre ndërkaj pak ditë më parë shpallëm edhe fazën e dytë të Programit të vetëpunësimit ku do të mbështeten edhe shumë punëkërkuësit të tjerë të riatdhesuar në Kosovë", ka thënë ministri Reçica. Gjithashtu, ministri i MPMS,

Skender Reçica, ka thënë se, krahas Programit të Vetëpunësimit, ne po mbështesim në punësim afatgjatë punëkërkuësit edhe nëpërmjet Programit të Subvencionimit të Pagës, në bashkëpunim edhe me bizneset, si përpjekje për të ndihmuar si punëkërkuësit po ashtu edhe bizneset në vend.

Hoti paralajmëron pako të re prej 182 milionë eurove për rimëkëmbjen ekonomike



PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të martën takim virtual me anëtarët e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë, i cili

ndërlidh aktivitetet e qeverisë dhe adreson sfidat e sektorit privat. Ai ka theksuar se përkundër situatës sfiduese në kohën që po përballemi me pandeminë

Covid-19, qeveria megjithatë ka siguruar funksionimin e shumicës së bizneseve. Kryeministri Hoti ka rikujtuar se gjatë muajit tetor janë ndarë 87 milionë euro, prej të cilave 60

milionë u janë ndarë komunitetit të biznesit, duke u ndihmuar atyre që të qëndrojnë në treg. Në këtë takim, kryeministri Hoti ka kërkuar që anëtarët e këtij Këshilli të dakordohen për pakon

e re për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2021, në shumë prej 182 milionë euro, si dhe për një listë të reformave për një pako të re fiskale, të cilat pritet të finalizohen në fillim të vitit të ardhshëm.

Komisioni për Ekonomi, Punësim e Tregti vendosi që të mbahet dëgjim publik për raportin e Komisionit Evropian



PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, i drejtuar nga Endrit Shala, kryetar, ka shqyrtuar të martën raportin e panelit për zgjedhjen e "Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit - ARRU", si dhe propozimin për kryesues dhe

anëtarë të Komisionit të Auditimit të NP KOSTT. Kryetari i komisionit Endrit Shala, njoftoi anëtarët e këtij komisioni se paneli për zgjedhjen e "Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit - ARRU", ka shqyrtuar dosjet e aplikantëve dhe ka përfunduar punën e tij në pajtim me ligjin. Prandaj, komisioni bazuar në

raportin e panelit i rekomandon Kuvendit që të votojë njërin nga kandidatët e përzgjedhur. Komisioni ka poentuar me më së shumti pikë kandidatët Naim Krasniqi dhe Gafurr Data. Raporti i shqyrtuar u votua unanimisht nga anëtarët e komisionit dhe si rrjedhojë, ky raport u procedua tutje për votim në seancë plenare. Po ashtu, komisioni shqyrtoi

propozimin për kryesues dhe anëtarë të Komisionit të Auditimit të NP KOSTT, duke konstatuar se tre kandidatët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Prandaj, komisioni i rekomandon Kuvendit për votim këta kandidatë: Arben Dodaj, Ajrina Gashi-Avdiu për anëtarë, si dhe Xhyldane Kiqmari kryesuese të këtij komisioni. Raporti në fjalë mori mbështetjen e të gjithë anëtarëve të komisionit

për të vazhduar tutje me votim në Kuvend. Fare në fund, komisioni diskutoi edhe për raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020, duke theksuar se ky raport ka dalë me disa rekomandime për institucionet e vendit. Për të diskutuar më në hollësi, komisioni vendosi që për këtë çështje të mbahet dëgjim publik në të ardhmen.

Ministri Mustafa mbështet aksionin e mbjelljes së 1.8 milionë fidanëve

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)- Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka folur në eventin e fillimit të fushatës "T'i japim vendit ngjyra", mes të cilës do të bëhet mbjellja e 1.8 milionë fidanëve në tërë Republikën e Kosovës, gjatë 10 viteve të ardhshme. Ministri Mustafa shprehi mbështetje për këtë projekt, duke qenë se ai është në vijë edhe me strategjinë e MBPZHR-së për pyllëzimin e hapësirave, objektivat e së cilit janë pyllëzimi dhe ripyllëzimi i

29,000 hektarë sipërfaqe. "Iniciativa e sotme e cila parasheh mbjelljen e 1.8 milion fidanëve përgjatë 10 viteve të ardhshme do të jetë vlerë e shtuar për vendin tonë dhe përkrahje për strategjinë që ka veçse Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", ka thënë ministri Mustafa. Tutje, ai ka theksuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka shënuar kthim pozitiv në rritjen e kapaciteteve të pyjeve. Kjo është arritur falë Programit

Kombëtar të Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit, i cili ka për qëllim të nxisë një pylltari të qëndrueshme në aspektin ekonomik e social. "Pyjet e Kosovës janë të definuar me ligj si resurse kombëtare. Hapësirat e gjelbra mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Republikës së Kosovës, andaj mbrojtja, mirëmbajtja, kultivimi, pyllëzimi dhe ripyllëzimi i tyre paraqet përgjegjësi dhe obligim me rëndësi të veçantë", ka deklaruar Mustafa.



Më 8 dhjetor mbahet dëgjim publik për master planin 'Penda e Livoçit' në Gjilan

GJILAN, 24 NËNTOR (ER)- Komuna e Gjilanit ka njoftuar zyrtarët, qytetarët, shoqatat, grupet e interesit dhe bartësit e institucioneve të komunës dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, se më 8 dhjetor prej orës 11:00 do të mbahet dëgjim publik virtual për master planin "Penda e Livoçit" në Gjilan.

Diskutimi publik ka për qëllim të ofrojë informata në lidhje me draft Master Planin "Penda e

Livoçit" në Gjilan të përgatitur nga ekspertë të jashtëm nga kompania "Geode" me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përmes projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat, ndërsa bartëse është Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe për të marrë opinione, sugjerime dhe komente të justifikuara për projektin në fjalë nga zyrtarët,

përfaqësuesit e sektorit privat, ekspertë, qytetarët dhe grupet e interesit (OJQ-të etj) dhe të tjerë për të finalizuar dhe siguruar cilësi të lartë të komponentëve të projekteve me interes të përgjithshëm publik. "Ju inkurajojmë për pjesëmarrje dhe vlerësojmë lartë kontributin tuaj në këtë dëgjim publik virtual i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën e Gjilanit", ka njoftuar Komuna e Gjilanit.



160 studentët të Drenasit nënshkruajnë kontratat për marrjen e bursës komunale



DRENAS, 24 NËNTOR (ER)- Studentët përfitues të bursës për vitin akademik 2020/2021 të Komunës së Drenasit kanë nënshkruar kontratat për marrjen e saj. Në sallën e Kulturës të Komunës së Drenasit, 160 studentët përfitues të bursës kanë pranuar kontratat e nënshkruara nga kryetari

Ramiz Lladrovci.

Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Muhamet Gjoka, ka uruar studentët për përfitim të bursës, duke shprehur përkushtimin e komunës për t'i përkrahur ata në rrugëtimi të dijes.

Ai i ka inkurajuar që edhe më tutje të vazhdojnë suksese në

studime dhe në rrugën e karrierës së tyre akademike. Kjo bursë është një stimulim për studentët, të cilët kanë bërë një punë të madhe gjatë studimeve dhe shërben si përkrahje për rezultatet e larta në studime. Këtë vit përfitues të bursës kanë qenë 160 studentët të nivelit bachelor të cilët kanë plotësuar kriteret e konkursit.

Vazhdojnë punimet për hapjen e rrugëve fushore në lagjen 'Gaxherr - Shalaj'

JUNIK, 24 NËNTOR (ER)- Komuna e Junikut ka bërë me dije se janë duke u zhvilluar punimet nga projekti "Hapja e rrugëve fushore" në lagjen "Gaxherr - Shalaj". Ky projekt financohet nga kjo komunë dhe ka për qëllim krijimin e kushteve më të mira infrastrukturore për banorët e kësaj ane. "Komuna

e Junikut në kuadër të iniciativës 'Shërbime të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik' po krijon kushte të mira infrastrukturore për zhvillim dhe qasje të lehtë për qytetarë. Projekti financohet nga Komuna e Junikut", ka njoftuar komuna që drejtohet nga Agron Kuçi.



Skenderaj stoliset për nderë të festave të nëntorit

SKENDERAJ, 24 NËNTOR (ER)- Në prag të festave të Nëntorit, sheshi i qytetit të Skenderajt dhe Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, kanë marrë pamjen kuq e zi, pamjen e flamurit rreth të cilit janë betuar burrat e gratë e atdheut tonë, për t'i shërbyer kauzës sonë për liri e pavarësi. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se lufta për shtet ende nuk ka përfunduar. "Krah flamurit tonë kombëtar dhe atij të UÇK-së po valëvitet i lirë edhe flamuri ynë shtetëror, i shtetit tonë të

ndërtuar me shumë mund e sakrificë. Lufta jonë nuk ka përfunduar, tani vazhdojmë të bashkuar, për të jetësuar amanetin e dëshmorëve e heronjve të kombit tonë, për të mbrojtur luftën e shenjtë të UÇK-së dhe identitetin e historinë tonë të lavdishme", ka thënë Jashari.

28 nëntori është një ndër festat më të rëndësishme shqiptare. Me këtë datë është shpallur Pavarësia e Shqipërisë (1912), ka lindur komandanti legjendar Adem Jashari (1955) si dhe ka dalë në skenë UÇK-ja (1997).



PERFORMACA E DOBËT E KOMUNËS SË PRISHTINËS NË SEKTORIN E MBROJTJES SË MJEDISIT!



Shkruan: Ferat SHALA,
profesor dhe deputet

Prishtina kryeqyteti ynë, do të duhej të ishte shembull i organizimit, qeverisjes dhe menaxhimit. Kjo për faktin se kryeqendra e shtetit është edhe qendra kryesore ku është e vendosura administrata shtetërore, përfaqësitë dhe ambasadat e vendeve të huaja, apo edhe zyrat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Kjo e bënë qytetin e Prishtinës, që të jetë pika kryesore e vizitave të delegacioneve të ndryshme të huaja por edhe turistëve të jashtëm. Andaj përshtypja e parë që marrin këta vizitorë për Kosovën, është përshtypja që jep kryeqyteti ynë.

Padyshim që një nga përshtypjet më të drejtpërdrejta që krijohet për Prishtinën dhe qeverisjen e saj, është ajo për gjendjen e mbeturinave, cilësia e ajrit, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra, planifikimi hapësinorë, transporti publik apo edhe shërbimet tjera publike. Nëse marrin për bazë treguesit e

lartpërmendur, fare lehtë munde të nxjerrët konkluzioni se performanca mjedisore e Komunës së Prishtinës është shumë e dobët, madje edhe më e dobët se sa e një pjese të konsiderueshme të komunave të tjera të Kosovës.

Përveç situatës mjedisore në terren që vërehet çdo ditë dhe që nuk kërkon ndonjë analizë specifike për të nxjerrë konkluzion, performanca e dobët mjedisore e Komunës së Prishtinës, është konfirmuar dhe prezantuar edhe nga raportet realizuara nga institucionet qendrore qeveritare, nga hulumtimet dhe analizat e realizuara nga organizatat joqeveritare që monitorojnë punën e Komunës së Prishtinës, apo edhe nga hulumtimet e organizatave të huaja që veprojnë në Kosovë.

Le të ndalemi dhe ti hedhim një vështrim këtyre vlerësimeve dhe të shohim më në detaje këtë situatë. Sipas raportit të performancës së Komunave të Kosovës për vitin 2019, të hartuar nga MAPL, në vlerësimin e përgjithshëm që përfshinë të gjithë treguesit, Komuna e Prishtinës renditet e 24-tra, me vetëm 51.9 për qind, të përmbushjes së treguesve, që është madje edhe më e ulët se mesatarja e komunave në nivel vendi (61.16 për qind).

Komuna e Prishtinës, renditet e

12-ta në nivel vendi për shërbimet e ujësjellësit, ndërsa e 28-ta me shërbimet e kanalizimit. Këtu është evidentuar po ashtu që në territorin e komunës nuk ka ende trajtim të ujërave të ndotura.

Sa i përket transportit publik, Komuna e Prishtinës renditet e 16-ta, ndërsa e 23-ta ajo renditet me infrastrukturë rrugore. Në këtë pikë duhet evidentuar po ashtu që Komuna e Prishtinës ka mungesë të shtigjeve për biçikleta në zonën urbane të qytetit.

Edhe më keq në renditje Prishtina, vlerësohet për performancën e saj të përgjithshme për mbrojtje të mjedisit. Ajo është e 27-ta sipas performancës në implementimin e kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.

Komuna e Prishtinës ka performacë të dobët edhe në sektorin e mbeturinave duke u renditur e 20-ta në nivel vendi me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në territorin e saj. Sipas Raportit për menaxhimin e mbeturinave komunale të hartuar nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit, menaxhimi i dobët i mbeturinave nga Komuna e Prishtinës, është evidentuar edhe sa i përket shërbimeve për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave, ku

kryeqendra jonë është ende në shkallën 0 për qind.

Në këtë raport, është evidentuar po ashtu se Komuna e Prishtinës ka rreth 20 deponi ilegale të mbeturinave në territorin e saj.

As Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave për vitin 2020 i USAID, nuk e nxjerr mirë performacën e Komunës së Prishtinës. Në vlerësimin e përgjithshëm Prishtina renditet e 14-ta. Sa i përket transparencës ajo renditet e 29-ta, ndërsa për administratë lokale e 21-ta.

Edhe raportet dhe analizat e Organizatës Joqeveritare Iniciativa për Progres (INPO), që monitoron punën e Komunës së Prishtinës, nuk flasin mirë për performancën e kësaj komune. Janë tejet shqetësuese dhe alarmante të dhënat që flasin se Komuna e Prishtinës, nuk arrin të realizon as 50% të buxhetit për investime kapitale.

Duke marrë parasysh nevojat e kryeqytetit për investime në përgjithësi dhe problemet në sektorin e mjedisit në veçanti një fakt i tillë tregon për keqmenaxhim dhe keqplanifikim nga ana e komunës.

Performanca e dobët mjedisore e Komunës së Prishtinës, vjen mes tjerash edhe nga shkalla e ulët e zbatimit apo mungesa e planeve lokale për sektorin e mjedisit. Sipas të dhënave të MAPL, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis i Komunës së Prishtinës është


implementuar vetëm 37 për qind.

Komuna e Prishtinës nuk ka Plan Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit edhe pse kjo është kërkesë ligjore sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Mungesa e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit për Komunën e Prishtinës ka qenë një vërejtje e vazhdueshme e evidentuar edhe në raportin e progresit të BE për Kosovën, duke ditur tejkalimet e paramterava të cilësisë së ajrit gjatë sezonës së dimrit. Madje Komuna nuk ka ende ndonjë angazhim konkret për hartimin e një plani të tillë.

Komunës së Prishtinës, i mungon edhe Plani Lokal për Mbrojtjen e Bidoversitetit, një dokument tjetër i nivelit lokal i paraparë sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës.

Këto janë vetëm disa nga dështimet e Komunës së Prishtinës, në menaxhimin e mjedisit në listën e gjatë të dështimeve që e bëjnë performancën e saj të zbehtë dhe të padenjë për një kryeqytet.

Kryeqyteti ynë Prishtina, dhe qytetarët e saj meritojnë një mjedis më të pastër dhe një jetë më të mirë. Mbase kjo duhet të ju shërbejë të gjithë atyre që jetojnë në Prishtinë si një sinjal që të mendojnë mirë herën tjetër kur të ju drejtohen kutive të votimit për të zgjedhur atë që do të kujdeset për mjedisin e tyre për periudhën e ardhshme.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita ndalet nga Feronikeli, Arbëria befason Gjilanin

Drita ka bërë një hap fals në garën për kreun e tabelës, pasi ka dështuar të arrin fitore në përballje me Feronikelin (1-1). Ndërsa në ndeshjen tjetër, Arbëria e befaso Gjilanin (1-0)



futbollistë cilësor. Prishtina është në ndjekje të titullit dhe do të mundohet ta shfrytëzojë edhe krizën e Llapit për të marrë tri pikët e plota, derisa Llapi që është duke e thelluar në vazhdimësi krizën e rezultateve, synim e ka të marrë pikë nga kjo ndeshje dhe ngadalë t'i ikën zonës së rrezikshme. Në ndeshjen tjetër në Mitrovicë, Trepça '89 e pret Besën. Nesër (e enjte) përfundon kjo xhiro me ndeshjen mes Drenicës dhe Ballkanit.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita është ndalur në barazim nga skuadra e Feronikelit (1-1). Pesë minuta pa përfunduar pjesa e parë e ndeshjes, Mendurim Hoti e kaloi në epërsi skuadrën mysafire. Në pjesën e dytë, Drita u mundua me të gjitha forcat për të barazuar rezultatit dhe ketë e arriti në minutën e 75-të, autor i golit ishte Almir Azeraj. Trajneri Klodian Duro u përjashtua për shkak të protestave, derisa në

dhjetë minutat e fundit mysafirët luajtën me një lojtar me pak, pasi Argjend Malaj u ndëshkua me karton të kuq. Edhe përkundër epërsisë numerike, Drita nuk arriti të gjejë golin e fitores dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-1. Drita mbetet në pozitën e dytë me 27 pikë, kurse Feronikeli është në pozitën e shtatë me 16 pikë. SC Gjilani ka pësuar një humbjes të papritur në ballafaqim me skuadrën e Arbërisë (1-0). Në pjesën e parë të ndeshjes u regjistruar disa gjysmeraste shënimi, por gola nuk pati. Në minutën e 76-të,

Billali i kaloi vendasit në epërsi. Në minutat në vazhdim mysafirët tentuan të barazojnë rezultatit, por pa sukses. Pas kësaj ndeshje, Arbëria ngritët në pozitën e 17 pikë të grumbulluara, derisa Gjilani mbetet në pozitën e tretë me 23 pikë.

Sot zhvillohen dy ndeshje

Sot (e mërkurë) do të zhvillohen dy ndeshje në Superligën e Kosovës në futboll. Në stadiumin "Zahir Pajaziti" zhvillohet derbi në mes Llapit dhe Prishtinës, skuadra që kanë diferencë të madhe pikësh mes vete, por që të dyja kanë

SUPERLIGA

Drita - Feronikeli 1-1
Arbëria - Gjilani 1-0

Të mërkurën takohen:
13:00 Llapi - Prishtina
13:00 Trepça '89 - Besa

Të enjten takohen:
13:00 Drenica - Ballkani

FFK-ja: Shefki Kuqi dhe shumë trajnerë tjerë janë vetofruar



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet një njoftimi për medie ka njoftuar se ende asgjë nuk është vendosur për përzgjedhësin e ri të U21-shave. Sipas FFK-së, trajneri Shefki Kuqi dhe shumë trajnerë ajanë vetofruar, kurse Komiteti Ekzekutiv do të analizojë mirë çdo gjë para se të vendosë për hapat konkret. "Deri më tash Komiteti Ekzekutiv ende nuk është mbledhur për të analizuar punën e ekipeve përfaqësuese zinxhirë dhe për të diskutuar rreth ndryshimeve eventuale. Fillimisht do të kërkohet raporti i punës nga menaxherët e ekipeve përfaqësuese dhe më pas do të

ftohen për bisedë trajnerët e secilës grupmoshë. Sigurisht se aty ku vlerësohet se është e nevojshme të ketë ndryshime do të ndërmerren hapat e duhur, por tash për tash nuk është zhvilluar asnjë takim me asnjë prej emrave që përmenden në media. Është e vërtetë që Shefki Kuqi ka shprehur interesim për të dhënë kontributin e tij për futbollin e Kosovës, por krahas tij janë edhe 7-8 emra tjerë që po ashtu kanë shprehur interesim për të qenë pjesë e ekipeve përfaqësuese dhe KE i FFK-së do të analizojë mirë çdo gjë para se të vendosë për hapat konkret", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Kosova kryen dy stërvitje në Sllovaki

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës të martën ka mbajtur dy stërvitje në Sllovaki. Skuadra ka kryer testin PCR për Covid-19, që ishte i treti, pasi basketbollistët e Kosovës dy herë janë testuar në Prishtinë. Atmosfera në kampin e Kosovës është shumë e mirë dhe lojtarët janë të motivuar për dy ndeshjet, ndaj Sllovakisë dhe Islandës, të vlefshme për parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës

2023. Gjithçka po shkon sipas planit të paraparë deri më tani dhe përzgjedhësi Christos Marmarinos është i kënaqur me ekipin dhe angazhimin e lojtarëve. "Kemi kryer një test për Covid-19 që kërkohet nga shteti sllovak. E kemi kryer testin e tretë PCR dhe deri më tani gjithçka është duke shkuar mirë. Erjon Kastrati na është bashkuar dhe ka stërvitur me ekipin. Jemi të vendosur në hotel dhe kemi

qasje vetëm në stërvitje dhe ndeshje, pasi që kështu e kërkon protokollin për Covid-19 i FIBA-s, të cilin duhet respektuar maksimalisht", ka thënë për faqen zyrtare të FBK-së, Granit Rugova, drejtor i përfaqësueseve. "Dardanët" janë liderë të grupit me dy fitore në dy ndeshje. Kosova në muajin shkurt të këtij viti mundi në Prishtinë, Islandën 80:78 dhe Luksemburgun në udhëtim 80:84.



Reja: Etrit Berisha ishte në negociata me Milanin dhe Juven

TIRANË, 24 NËNTOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edi Reja, zbuloi një prapaskenë të bujshme merkatoje. Bëhet fjalë për portierin Etrit Berisha. Në një prononcim të dhënë së

fundmi për mediet italiane, Reja zbuloi se Berisha ishte pranë akordit me Juventusin dhe Milanin në merkaton e verës, për t'u transferuar si portier i dytë, por gjithçka dështoi për shkak të

pandemisë. "SPAL-i ka bërë një goditje të madhe duke mbajtur Berishën. E meriton ende të luajë në Serie A, ndërsa kishte negociata shumë konkrete me Juventusin dhe Milanin për të

qenë portier i dytë, kurse në mbyllje të merkatos ishte në negociata edhe me Spezian. Por më pas, në një situatë kaq të bllokuar, nuk u konkretizua asgjë", shpreh Reja për "Il Resto del Pugno".



Interi kërkon tri pikë në finalen ndaj Realit



MILANO, 24 NËNTOR (ER) - Skuadra e Interit dhe ajo e Real Madridit do të përballen sonte (e mërkurë) në kuadër të Grupit B në Ligën e Kampioneve. Skuadra italiane është e fundit në grup me vetëm dy pikë të grumbulluara dhe i duhet fitorja nëse dëshiron kualifikimin në fazën tjetër. Në anën tjetër Realit do të mundohet të marrë të paktën një pikë, me synim që të fitojë dy ndeshjet e fundit dhe të kualifikohet tutje. Në ndeshjen e zhvilluar më 3 nëntor, Realit fitoi me rezultat 3-2. "Për ne është si një finale. Pas humbjes kundër Realit, nuk kemi zgjidhje tjetër. Na pret një ndeshje e vështirë, duhet të luajmë në mënyrë perfekte. E dimë që mund të marrim rezultatin që synojmë, e kemi reguar edhe në të kaluarën. Me pak

kujdes mund ta fitojmë ndeshjen. Nuk e di, nuk mendoj se Realit mund të qahet. Ka shumë lojtarë që mund t'i zëvendësojnë, më vjen për të qeshur që mediet flasin për këto mungesa", ka thënë Antonio Conte, trajneri i Interit. Kryesuesja e grupit, Borussia Moenchengladbach e deklasoi Shakhtarin në ndeshjen e kaluar duke e mposhtur (0-6), kurse edhe tash e synon fitoren për të qenë afër kualifikimit. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Angli ku Liverpooli e pret Atalantën e Berat Gjimeshitit, nga e cila ndeshje synon maksimumin e pikëve edhe përkundër problemeve me lëndime. Ajaxi kërkon tyri pikët e reja kundër Midtjyllandit për të "blinduar" pozitën e dytë në grup.

GRUPI A		
21:00 Atletico M. - Lokomotiv M.		
21:00 Bayern M. - Salzburg		
Tabela		
1. Bayern M.	3	9 pikë
2. Atletico M.	3	4
3. Lokomotiv M.	3	2
4. Salzburg	3	1
GRUPI B		
18:55 B.Moenchengladbach - Shakhtar D.		
21:00 Inter - Real Madrid		
Tabela		
1. B.Moenchengladbach	3	5 pikë
2. Shakhtar D.	3	4
3. Real M.	3	4
4. Inter	3	2
GRUPI C		
18:55 Olympiacos - Manchester City		
21:00 Marseille - Porto		
Tabela		
1. Manchester City	3	9 pikë
2. Porto	3	6
3. Olympiacos	3	3
4. Marseille	3	0
GRUPI D		
21:00 Ajax - Midtjylland		
21:00 Liverpool - Atalanta		
Tabela		
1. Liverpool	3	9 pikë
2. Ajax	3	4
3. Atalanta	3	4
4. Midtjylland	3	0

SHKURT

Lowi mund të shkarkohet më 4 dhjetor

Federata Gjermane e Futbollit do të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme me 4 dhjetor ku pritet të vendoset e ardhmja e trajnerit Joachim Low. Pas humbjes ndaj Spanjës, dhe rezultateve të dobëta në Ligën e Kombeve, Low rrezikon të shkarkohet nga detyra e trajnerit. Për këtë pozitë janë përmendur emrat e Jurgen Klopp, Julian Nagelsmann dhe Hans-Dieter Flick.

Trajneri i njohur bullgar vdes nga Covidi

Trajneri i njohur bullgar, Nikola Spasov e ka humbur betejën me Covid-19. Tekniku i skuadrës së Montanës, pasi u infektua me Covid, qëndroi 3 javë në spital periudhë në të cilën nuk arriti të fitonte betejën me jetën. Trajneri i ndjerë, ka pasur një karrierë të suksesshme edhe si futbollist, teksa u shpall kampion në vitin 1978 me Lokomotivën e Sofjes. Si trajner suksesin më të madh e regjistroi në vitin 2015 me Çerno More Varna, ku fitoi Kupën dhe Superkupën bullgare.

Erikseni mund të shkëmbehet me Iscon

Mesfushori i Danimarkës, Christian Eriksen mbetet në qendër të vëmendjes dhe tani në Itali raportojnë për një tjetër skenar, që e bën atë pjesë të Real Madrid në këmbim të Iscos. Mesfushori spanjoll dëshiron të largohet nga Realit dhe për trajnerin Antonio Conte do të ishte një alternativë më e mirë për mesfushën. Edhe për danezin kalimi në La Liga shikohet si lëvizja e duhur.

Ish-sulmuesi i Barcelonës akuzohet për ngacmim seksual

Ish-sulmuesi spanjoll, David Villa është akuzuar nga Skajler Badillo, për ngacmim seksual. Vajza në fjalë ishte praktikante te klubi i futbollit Nju Jorg Siti, teksa ka bërë një rrëfim surprizues që është duke bërë xhiron e mediave prestigjioze. Badillo, e cila ishte 20-vjeçe kur u bashkua me ekipin amerikan, pretendon se David Villa, e prekte dhe e provokonte vazhdimisht në mënyrë të bezdisshme. Ajo gjithashtu tregoi se sulmuesi spanjoll, i cili luajti për NYC FC nga 2014 në 2018, i ofroi asaj alkool. "Ai filloi të më pyeste se çfarë lloj alkooli pi, unë isha 20 vjeç në atë kohë. Unë iu përgjigja që nuk pi me të vërtetë, ai po pyeste se vazhdimisht, 'çfarë lloj alkooli duhet të blej' në mënyrë që të shkoja në apartamentin e tij për festë. Shikova ndihmës trajnerin e NYC FC, Melvyn Pamplona dhe i thashë se unë nuk mendoj se kjo është një bisedë e mirë për tu zhvilluar, duke shpresuar se ai do të më ndihmonte, dhe përgjigja e tij ishte, mirë ishte vetëm një pyetje", ka thënë ajo.

Saranda Daci transferohet në Çeki

PRIZREN, 24 NËNTOR - Njëra nga basketbollistët më të dalluara të Bashkimit dhe Superligën e Femrave, Saranda Daci do të transferohet në Superligën e Çekisë, në skuadrën Slovanka MB. Ky është një hap i madh në karrierën e Dacit, që më herët ka qenë pjesë e Prishtinës dhe Penzës, duke fituar shumë trofe në basketbollin e Kosovës dhe duke qenë njëra nga lojtaret më të mira në Superligën e Femrave. Klubi i Bashkimit i ka uruar suksese në aventurën e re dhe nuk e ka ndalur, përkundër se është njëra nga lojtaret më të mira në skuadër, që ka synime të mëdha në këtë edicion. Ky është një hap i madh për Saranda Dacin, por edhe basketbollin e femrave, që një lojtare do të transferohet në Superligën çeke. Saranda pritet të jetë pjesë e Kosovës në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor.



LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirim kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhësi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË (1990-1991)

ISBN 978-9951-780-24-7
9 789951 780247


“A po shkruan Barney?”
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
 “A po të shiten librat?”
 “Po marrë çeçe nga të drejtat e autorit”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”
 “Për femrat moderne”.
 “Për femrat moderne?!”
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrsisht të këqija”.
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkiten dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €

ISBN 978-9951-780-19-3
9 789951 780193

Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mërgim Sylja shpall të pavlefshme dëftesat e Shkollës së Mesme "Abdyl Frashri" në Prishtinë.
- "Eastern Adeem Co.For Trading Branch of Kosovo" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810114512
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

